



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-klina.org



REPUBLIKA KOSOVA			
MUNICIPALITY OF KLINA OPŠTINA KLINA			
Pranuar më datë: Received on: 31.05.2024 Prilajeno dana:			
Nëseja org. Unit Organi. Jed.	Numeri Number Broj	Shënime Remarks Zabeleške	Shuma Amount Iznos
02- 052- 17725/24			

**RAPORTI NGA PROCESI I ORGANIZIMIT TË KONSULTIMIT
PUBLIK PËR DRAFT - PLANIN LOKAL TË VEPRIMIT PËR
BARAZINË GJINORE 2024 - 2026**

Qershor, 2024

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) 2024 - 2026 u përgatit nga Komuna e Klinës si mjeti kryesor i zbatimit të angazhimeve publike për barazinë gjinore të reflektuara në:

Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit.

Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020, si dhe tërësinë e ligjeve të vendit të fokusuara tek barazia, mosdiskriminimi dhe fuqizimi i grave.

Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024, si dhe tërësinë e kornizës zhvillimore vendore (programe e strategji) për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave.

Instrumente dhe mjete të BE-së të fokusuara tek barazia gjinore, si pjesë e procesit të integritetit, veçanërisht ato që përmbajnë veprimet që duhet të ndërmerren në nivelin lokal – siç është edhe Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore u përgatit përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me institucionet publike lokale, organizatat e shoqërisë civile, Grupin e Grave Asambleiste, organizatat ndërkombëtare, Kuvendin Komunal dhe me zërat e banoreve dhe banorëve të Komunës së Klinës, të cilat / cilët patën mundësi të njihen dhe të japin komentet e tyre mbi këtë dokument përgjatë procesit të konsultimit publik. I gjithë procesi u mbështet nga UN Women Kosovë në kuadër të zbatimit të projektit “Gender Equality Facility” (GEF) me fonde të Bashkimit Evropian.

Siç përshkruhet edhe në tekstin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, njësitë e vetëqeverisjes lokale janë sfera të qeverisjes që gjenden më pranë njerëzve, ndaj dhe përfaqësojnë nivelet që kanë më tepër mundësi të luftojnë vazhdimësinë dhe riprodhimin e pabarazive, si dhe të avancojnë për një shoqëri me të vërtetë të barabartë. Këto mund të arrihen duke ndërthurur zbatimin e kompetencave të tyre me bashkëpunimin me të gjithë gamën e aktorëve lokalë, për veprime konkrete në favor të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve.

Zbatimi dhe promovimi i të drejtës së barazisë duhet të qëndrojë në zemër të konceptit të vetëqeverisjes lokale. Barazia gjinore prej vitesh është evidentuar si një çështje me përparësi në nivel vendi, e për këtë qëllim edhe në nivelin lokal është punuar e po punohet vazhdimisht. Në nivel vendi, në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024, i cili bazohet në Ligjin Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore, jepen qartësisht fushat kryesore të ndërhyrjes, si dhe objektivat specifike për zbatimin e të cilave duhet të punojnë së bashku institucionet qendrore, lokale, OJQ-të dhe të gjithë partnerët lokalë, kombëtarë e ndërkombëtarë.

ECURIA E PROCESIT TË KONSULTIMIT PUBLIK PËR DRAFT - PLANIN LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2024 - 2026

Kryetari i Komunës së Klinës në bashkëpunim me Drejtorinë e Administratës (Iniciuesi apo propozuesi i aktit), Zyrën për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, si dhe Zyrën për Barazinë Gjinore, duke respektuar UDHËZIMIN ADMINISTRATIV (MAPL) NR.04/2023 PËR ADMINISTRATË TË HAPUR NË KOMUNË, më vendim më numër protokoli 01 Nr. 112-9278, të datës 25.03.2024, kanë caktuar grupin punues në përbërje prej shtatë anëtarëve:

1. Marqe Selmanaj, kryesuese
2. Vitore Shala, zv. kryesuese
3. Fatjona Gashi, anëtare
4. Shemsi Bajraktari, anëtarë
5. Melihate Behramaj, anëtare
6. Enver Maia, anëtarë
7. Vlora Tafili, anëtare.

Grupi punuese si dhe Zyrtari Përgjegjës për Konsultim Publik kanë hartuar planin e brendshëm të organizmit të konsultimit, agjendën, identifikimin e palëve, identifikimin e mjeteve të komunikimit, identifikimin e burimeve, mjeteve, formave dhe mënyrave të nevojshme për procesin e konsultimit publik si dhe përmbylljen e procesit me shqyrtimin e kërkesave.

Përveç dy takimeve të drejtpërdrejta me publikun, takimi i parë i mbajtur më datë 14.05.2024 në sallën e Kuvendit të Komunës, në ora 13:00, si dhe takimi i dytë i datës 20.05.2024 në Qendrën e Angazhimit të Komunitetit (QAK), ish-qendra rinore “Ardhmëria”, në ora 14:00, grupi punues ka shfrytëzuar metodën për konsultim me qytetarët prej 30 ditësh në ueb-faqen zyrtare të komunës dhe në platformën e konsultimit publik në nivel të qeverisë së Republikës së Kosovës:

Komuna Klinë : <https://kk.rks-gov.net/kline/category/konsultimet-publike/?page=2023>

Platformën e konsultimeve publike – Qeveria e Kosovës: <https://konsultimet.rks-gov.net/>

Materiali për konsultim publik iu është mundësuar të gjithë të interesuarve të merret në formë fizike në **Drejtorinë e Administratës** dhe në **Zyrën për Barazi Gjinore**. Po ashtu, ka qenë i publikuar edhe në ueb-faqen zyrtare të **Komunës së Klinës** si dhe në **Platformën e Qeverisë së Kosovës për Konsultime Publike**.

Komuna e Klinës e ka të paraparë organizimin e këtij konsultimi publik edhe më
PLANIFIKIMIN E KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2024:

Nr.	Emri i konsultës	Koha e mbajtjes së konsultës
1.	DRAFT-PLANIN LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2024 – 2026.	PRILL 2024

Shtojca nr. 1 – Tabela e detajuar me numrin e takimeve, pjesëmarrësve dhe numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime:

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime
Takimi i drejtpërdrejtë	Takimi i parë: 14.05.2024 në sallën e Kuvendit të Komunës, në ora 13:00, Takimi i dytë: 20.05.2024 në Qendrën e Angazhimit të Komunitetit (QAK), ish-qendra rinore “Ardhmëria”, në ora 14:00.	32 pjesëmarrës	0 pjesëmarrës kanë parashtruar komente
Platformat elektronike	24.04.2024 24.05.2024	0 pjesëmarrës	0 pjesëmarrës

Dokumentet e lartcekura i janë nënshtruar konsultimit publik në ueb-faqen e Qeverisë së Kosovës për Konsultime Publike:

REPUBLIKA E KOSOVËS
QEVERIA - ZYRA E KRYEMINISTRIT
ZYRA PËR QEVERISJE TË MIRË

Shqip | English | Srpski

Ballina

Lajmet

Rreth platformës

Institucionet

Kërko konsultë

Takimet konsultative

Dokumentet

Statistika

Kontaktet

Kycu

Konsultimet publike

30.05.2024

Komuna Klinë/Lista e konsultimeve publike

Te hapura

Te mbyllura

Emri konsultes	Data e fillimit	Data e përfundimit	
Njoftim për Konsultim Publik të Draft- Planit Lokal të Veprimit për Barazine Gjinore 2024 - 2026	24.04.2024	24.05.2024	Shiko
Njoftim për Konsultim Publik për Draft-Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa Komunale	17.04.2024	03.05.2024	Shiko
Njoftim për konsultim publik lidhur me DRAFT- STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 - 2027) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 - 2026)	28.03.2024	11.04.2024	Shiko
Njoftim për konsultim publik për PROJEKT- RREGULLORJA PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHEM, SISTEMATIZIMIN DHE KLASIFIKIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË KOMUNËN E KLINËS dhe ORGANOGRAMIN E KOMUNËS SË KLINËS	11.03.2024	25.03.2024	Shiko
KONSULTIM PUBLIK - DRAFT - RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E KLINËS	17.03.2023	28.03.2023	Shiko
KONSULTIM PUBLIK - Draft-Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027	17.03.2023	28.03.2023	Shiko
DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL PËR KOMUNËN E KLINËS 2022-2027	08.11.2022	22.11.2022	Shiko
DRAFT-RREGULLORE PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E	08.11.2022	22.11.2022	Shiko

Gjatë fazës së Konsultimit Publik, grupi punues nuk ka pranuar asnjë (0) kërkesë apo (0) rekomandim nga palët e interesit.

Shtojca Nr. 3 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë:

Femra	30
Meshkuj	5
Total:	35

Kryesuesja e Grupit Punues,
Marqe Tanushi – Selmanaj



Klinë, 30.05.2024

